

VENDIM
Nr.870, datë 12.8.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM,
TË KOMUNËS PREZË TË QARKUT TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Prezë të qarkut të Tiranës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Prezë të qarkut të Tiranës, miratuar me vendimin nr.903, datë 19.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Prezë të qarkut të Tiranës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Prezë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha
Lidhja nr.1

Komuna Prezë

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i pronës
1-8	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
9-12	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
13-17	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
21-23	Varreza publike	Në pronësi
147-237	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
24-27	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në strehimin dhe mbrojtjes civile.	Në pronësi
29	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
30-34	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
61-128	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive).	Në pronësi